



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:160477
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05478485

C.A.P.nr.1453/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga Gjykatësi Individual Besnik Feka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.K. për F. me E.E.(Sh.a KESco), me seli në Prishtinë, kundër debitorit A. U. nga fshatixxx, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit K. K.për F. me E. E. (Sh.a KESco), me seli në P., ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CPP.nr.88/2023, i datës 28.08.2023, me datë **20.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e kreditorit K. K. për F. me E. E.KESCO Sh.a me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, me numër CPP.nr.88/2023, i datës 28.08.2023, në pikën **I** dhe **II** të dispozitivit **VËRTETOHET**.

II. Pikat **III** dhe **IV** e dispozitivit të aktvendimi të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, me numër CPP.nr.88/2023, i datës 28.08.2023, **ngelin të pa shqyrtuara**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin e ankimuar, CPP.nr.88/2023, i datës 28.08.2023, ka vendosur si në vijim:

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** i bazuar prapësimi i debitorit A.U. nga fshati B., komuna V.

- II. SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri përmbarimor P.nr.202/23 të datës 07.07.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Fazli Gjonbalaj me seli në Vushtrri, përkatësisht për shumën e borxhit prej 1,381.25 euro për periudhën kohore prej 25.08.2016 deri më 31.12.2021 për shkak të parashkrimit.
- III. MBETET PJESËRISHT NË FUQI për pjesën tjetër në shumën prej 304.68 euro për periudhën kohore prej 01.01.2022 deri me 08.06.2023.
- IV. OBLIGOHET debitori A.U., që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktvendimi, kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (Sh.a KESco), me seli në Prishtinë, në emër të borxhit për shfrytëzimin e shërbimeve të energjisë elektrike për periudhën kohore prej 01.01.2022 deri me 08.06.2023, t'ia paguaj shumën prej 304.68 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbarim, me datën 07.07.2023 e deri në pagesën definitive të borxhit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin e përcaktuar ligjor ankesë ka ushtruar kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a. (KESCO) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe duke marrë parasysh interesin juridik të parashtruesit të ankesës, konsiderohet se i njëjti aktvendim i ankimuar e ka kundërshtuar pjesërisht dhe atë vetëm në pikën I dhe II të dispozitivit në pjesën e shfuqizuar të Urdhërit për Lejimin e Përmbarimit, me propozim për gjykatën e shkallës së dytë, që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, dhe të priset aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim dhe në rivendosje.

Përgjigje në ankesë, brenda afatit ligjor ka paraqitë debitori A. U. nga fshati B./Komuna e V., duke e kundërshtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit me propozim për gjykatën e shkallës së dytë që ankesa të refuzohet dhe vërtetohet aktvendimi në pjesën e goditur me ankesë.

Gjykatësi Individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, 17 dhe 77 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209, pika b) të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me energji Elektrike KESCO sh.a me seli në Prishtinë, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 07.07.2023 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, kundër debitorit, lidhur me borgj të energjisë elektrike për periudhën kohore nga data 25.08.2016 e gjer me datën 08.06.2023, në shumën 1,1685.93 €.

Përmbaruesi Privat me Urdhërin për Lejimin e Përmbarimit P.nr. 202/23, i datës 07.07.2023, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, pas pranimi të urdhërit për përmbarim, ka ushtruar prapësim ndaj urdhërit përmbarimor si më lartë duke e kontestuar borxhin në tërësi, se borxhi është parashkruar ndërsa ka propozuar aprovimin e kundërshtimit dhe shfuqizimin e urdhërit përmbarimor.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim duke theksuar se debitori ka bërë pagesa të kohë pas kohshme me të cilat e ka pranuar borxhin dhe e ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit dhe atë në bazë të nenit 368 par 1 të LMD-së, ku është përcaktuar se “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ndërsa në par.2 të këtij neni, përcaktohet se: “Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit vecse edhe në mënyrë të tërthort sikurse janë pagesa e këstit, kamatës, dhënia e sigurimit”.

Gjykata e shkallës së parë, pas pranimi të prapësimit të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, nxjerr aktvendimin e ankimuar ku gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, prandaj, edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në arsyetimin e saj lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit të paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.202/23 të datës 07.07.2023, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe provave të tjera të bashkangjitura, gjeti se prapësimi i debitorit A.U. është pjesërisht i bazuar dhe kjo për këto arsye:

Sipas vlerësimit të gjykatës, dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, pra, ekstraktit të verifikuar nga librat afariste – transaksionit të konsumatorit me numër DMI-9045954 dhe numër të njehsorit 64662165, është dokument i besueshëm konform nenit 29, par. 1, pika 1.2 të Ligji 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore ku parashihet *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave: dhe po ai ekstrakt, bazuar në nenin 29 par.3 i cili parasheh “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.”* është i përshtatshëm për përmbarim pasi që në të njëjtin është treguar kreditori, debitori, objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes.

Po ashtu, propozimi për përmbarim është paraqitur konform nenit 37, i Ligji 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i cili parasheh *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, e që në rastin konkret dokumenti i besueshëm është bashkangjitur në origjinal nga kreditori, dhe nenit 38 par.1, të po të njëjtit ligj, i cili parasheh *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur,*

si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.”, pra, propozimi për përmbarim përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me nenin 37 dhe 38 par.1 të LPP-së.

Gjykata lidhur me pretendimin e debitorit se borxhi i kërkuar nga kreditori është parashkruar, gjeti se i njëjti është pjesërisht i bazuar për faktin se borxhi i krijuar për debitorin për periudhën prej 25.08.2016 deri më 31.12.2021 në shumë 1,381.25 euro është borxh i parashkruar konform nenit 360, par.1, nën par. 1.1 Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku parashihet *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa sa i përket rrjedhjes së afatit të parashkrimit, në nenin 360, par.2 të të njëjtit ligj parashihet *“Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*.

Tutje, gjykata, vlerëson se në rastin konkret, edhe pse debitori ka kryer pagesa të kohëpaskohshme, nuk ka bërë pranimin e borxhit, për faktin se neni 368 par.1 parasheh *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.”* ndërsa par.2 i po të njëjtit nen parasheh *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.”*, e që sipas gjykatës, pagesat e kohëpaskohshme, paushalle, në formë të kësteve, pa specifikuar se për cilin muaj të shpenzimit të energjisë elektrike kanë të bëjnë, e që në rastin konkret këto pagesa janë emërtuar vetëm si *“pagesa të energjisë elektrike”*, nuk shkaktojnë ndërprerjen e parashkrimit, kjo për faktin se pagesa e borxhit në formë të kësteve mund të vijë në shprehje vetëm pas një marrëveshje (kontrate) për pagesën (ri programimin) e borxhit ndërmjet kreditorit dhe debitorit, e që në rastin konkret, në shkresat e lëndës nuk ka prova se një marrëveshje (kontratë) e tillë ekziston ndërmjet palëve dhe nuk ka asnjë provë tjetër e cila do të mund të konsiderohej si pranim i borxhit nga ana e debitorit.

Për më tepër edhe Gjykata Supreme përmes aktgjykimit Rev.nr.148/2012 të datës 09.09.2013 (faqe 3, paragrafi 4) ka mbajtur qëndrimin se pagesat paushalle, të kohëpaskohshme, për të cilat nuk është specifikuar asnjëherë se për cilin muaj të shpenzimit të energjisë elektrike kanë të bëjnë, nuk shkaktojnë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit.

Gjykata gjeti se debitori për periudhën 01.01.2022 deri me 08.06.2023 ka krijuar borxhin në shumë prej 304.68 euro, i njëjti është i bazuar dhe se nuk është parashkruar duke pasur parasysh dispozitën e nenit 360.2 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve me të cilën parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura gjatë vitit 2022, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga 01.01.2023 dhe për të gjitha kërkesat e arritura gjatë vitit 2023, afati i parashkrimit do të fillonte të rrjedhë me 01.01.2024, ndërsa, në rastin konkret, kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarim me datën 07.07.2023 ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit për kërkesat e arritura gjatë vitit 2022 dhe 2023, ndërsa kërkesat e arritura prej 25.08.2016 deri me 31.12.2021 janë parashkruar.

Pretendimin e debitorit se i njëjti nuk është faturuar me rregull andaj nuk është i njoftuar për borxhin, gjykata e refuzoi si të pabazuar, pasi që debitori nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të mund të vërtetohej se i njëjti ka paraqitur ndonjë ankesë lidhur me këtë çështje te kreditori.

Gjykata, lidhur me kamatën ligjore, iu referua nenit 382, par.1 dhe 2 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndërsa sa i përket afatit të rrjedhjes së kamatëvonesës i referohet mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/20, datë 01.12.2020, respektivisht par. II, III dhe VI të këtij mendimi dhe gjeti se, debitori ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit nga data kur është ushtruar propozimi për përmbarim e tutje.

Gjykata, vlerësoj pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim, por gjeti se nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga ajo që u tha më lartë e në pajtim me nenin 43 par.4, nenin 73 pika par.3 të LPP-së, e lidhur me nenin 360 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, në lidhje me nenin 17 të LPP-së, , gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe se e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë konstatohet se objekt i shqyrtimit në këtë çështje përmbarimore ka qenë detyrimi i pretenduar i kreditorit ndaj debitorit për periudhën kohore 25.08.2016, e gjer më 08.06.2023, në shumë të përgjithshme prej 1,685.93 euro, dhe gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas pretendimeve të debitorit në prapësimin e ushtruar kundër Urdhërit për Lejimin e Përmbarimit, me aprovimin e pjesërishëm të tij ka nxjerr përfundimin se shuma e borxhit prej 1,381.25 euro, e krijuar për periudhën kohore 25.08.2016 e gjer më 31.12.2021, është shumë e parashkruar, konform nenit 360 par.1, nënpar.1.1, ku përcaktohet afati 1 vjeçar i parashkrimit të detyrimit, dhe rrjedhja e këtij afati sipas nenit 360 par.2, llogaritet nga fundi i vitit në të cilin arrihet kërkesa për pagesë, në rastin konkret për kërkesat e arritura për pagesë të krijuara gjer me datën 31.12.2021, afati i parashkrimit fillon të llogaritet nga data 01.01.2022 e tutje, dhe mbi këtë bazë është konstatuar me të drejtë se shuma e borxhit prej 1,381.25 euro është detyrim i parashkruar, ngase kreditori propozimin për përmbarim e ka ushtruar 07.07.2023,, me çka sipas nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 e ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e tutje.

Gjykatës së Apelit, i rezultojnë të pa bazuara pretendimet ankimore të kreditorit se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka llogaritur afatin e parashkrimit në rastin konkret ngase debitori gjatë periudhës kohore 25.08.2016 e gjer me datën 31.12.2021, ka bërë pagesa të kohë pas kohshme në shumat e evidentuara në ekstraktin e dorëzuar nga kreditori, dhe këto pagesa janë bërë në emër të borxhit të përgjithshëm, mirëpo, marrë për bazë nenin 368 par.1 dhe 2 të LMD-së, dhe me shikim në ekstraktin e dorëzuar nga kreditori, konstatohet se është fakt se debitori ka bërë pagesat në fjalë në emër të borxhit të përgjithshëm, mirëpo, në mes të kreditorit dhe debitorit paraprakisht nuk ka ekzistuar një marrëveshje eventuale për ri programim të borxhit, e një ashtu pagesat në fjalë nga debitori nuk e kanë efektin e pagesës së kësteve sipas nenit 368 par.2 të LMD-së, dhe këto pagesa të bëra nga debitori nuk janë paguar në emër të lartësisë së faturës mujore si detyrim i debitorit ndaj kreditorit, mirëpo, janë pagesa paushalle dhe jo të saktësuar

për muajin përkatës në të cilin bëhet pagesa, ndërsa sa i përket pranimit të borxhit nga debitori, ky pohim duhet të shoqërohet me plotësimin kumulativ të dy kushteve dhe atë pohimit të bazës juridike nga e cila rrjedh detyrimi mes palëve dhe pohimi i lartësisë së këtij detyrimi, e që në rastin konkret debitori nuk e kundërshton bazën juridike nga e cila rrjedh detyrimi karshi kreditorit, mirëpo e kundërshton lartësinë e këtij detyrimi dhe nisur nga kjo nuk mund të cilësohet pranim i borxhit nga debitori sipas nenit 368 par.1 të LMD-së, ndërsa pagesat e bëra nga debitori nuk janë pagesa në lartësi mujore të detyrimeve periodike që debitori ka krijuar në emër të konsumit të energjisë elektrike, dhe rrjedhimisht as nuk mund të vlerësohet se me këto pagesa debitori ka pohuar borxhin dhe ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit, ngase të këto kontrata janë kontrata të natyrës formularë dhe çdo herë interpretimi i dispozitave materiale në rastin konkret afateve të parashkrimit që janë objekt i detyrimit kontraktues të kontratës mbi shërbimin e energjisë elektrike, duhet të interpretohen në favor të debitorit, duke marrë për bazë edhe sjelljen e tij në raport me kreditorin, si dhe pasivitetin e kreditorit që brenda afatit 1 vjeçar nga fund viti i arritjes së kërkesës për pagesë të detyrimit të kërkoj përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, me këtë gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e llogaritjes së afatit të parashkrimit të invokuar nga debitori në prapësimin e ushtruar, drejtë ka bërë llogaritjen e shumës së parashkruar të detyrimit të kreditorit prej 1,381.25 euro për periudhën kohore 25.08.2016 e gjer më 31.12.2021, dhe vendosja nga gjykata e shkallës së parë është vendosje e drejtë dhe në përputhje me nenin 360 par.1, nënpar.1.1, në lidhje me paragrafin 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe vërtetimin e gjendjes faktike sipas shkresave të lëndës.

Meqë, pikat **III** dhe **IV** të dispozitivit të Aktvendimit të goditur me ankesë, nuk është atakuar, duke iu përmbajtur kufizimeve ligjore nga neni 194 i LPK-së(kufinj të ekzaminimit të ankesës), dhe institutit “Reformatio in Peius”, nga neni 203 i LPK-së, gjykata e shkallës së dytë, pikën **III** dhe **IV**, të dispozitivit të aktvendimit të kundërshtuar me ankesë nuk i shqyrtoi fare.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 17, 77 të LPP-së, në lidhje me nenin 194, 208, 209 pika b) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.1453/2023, me datë 20.03.2024

Gjyqtari Individual
Besnik Feka